



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
AUTORITETI KONTRAKTOR
SPITALI RAJONAL DURRËS

Nr. _____ prot.,

Data ____/____/2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - shërbim (e hapur)

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

Objekti: Transport dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme Spitalore për Spitalin Rajonal Durrës - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik -- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj

Fondi limit: 9,866,166.84 (nente milion e teteqind e gjashtedhjetë e gjashtë mijë e njëqind e gjashtedhjetë e gjashtë pike tetedhjetë e kater) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Spitali Rajonal Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

1.1. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10.

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.*

1.2. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM-se nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të perlllogaritur. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me piken 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; në piken 1 dhe piken 2/a të nenit 43 të VKM-se nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku përcaktohet: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së perlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar; Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim të bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara me poshtë, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në piken 1 dhe piken 2/a të nenit 43 të VKM-se nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohej në Procedurën e Hapur, ku përcaktohet: Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së perlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM-se 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' i ndryshuar ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenin 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore të ardhurave.

2.2.2 Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë prej jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, të këtij objekti, të realizuara në një nga tre vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës të kësaj procedure prokurimi.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohej vërtetimi të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të

furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar ne organet tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar ne organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar ne organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Gjithashtu referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më shumë se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

2.3 Kapaciteti teknik dhe të tjera (fuqia punetore, mjetet etj):

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë të gjitha Çertifikatat si më poshtë vijon:

- ISO 9001:2015 (Sistemi Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalent;
- ISO 14001:2015 (Sistemi Menaxhimit të Mjedisit) ose ekuivalent;
- ISO 45001:2018 (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve nëpunë) ose ekuivalent

Çertifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe brenda afatit të vlefshmerisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenit 40, pika 4/a dhe nenit 44 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Bazuar në këto dispozita Autoriteti ose enti kontraktor

mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon: a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara; b) efikasitetit të energjisë; c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

- ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo

Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime me të ulta.

- ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me

ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike.

Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

- ISO 45001:2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet për menaxhimin praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001:2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbytje me sukses të kontratës së shërbimit objekt prokurimi.

- AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Certifikatat e kërkuara 3, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Certifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të disponojë:

- 1. Licence III.2.B (Grumbulli, transportim, ruajtje, riciklim dhe asgjësim i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme) e shoqëruar me akt miratim.**
- 2. Leje mjedisore Tipi A, kodi III.1.C e shoqëruar me akt miratim që të përfshijnë kodet e mbetjeve të rrezikshme si me poshte:**
 - 18 01 02 - Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03);**
 - 18 01 08 - Medikamente citostatike dhe citotoksike.**
 - 18 01 09 – Medikamente të tjera përveç atyre të përmendura në 18 01 08;**

- 3. Leje mjedisore të tipit A (me kod III.1.C) ose të tipit B (me kod III.1.B) së bashku me Akt Miratimin përkatës e shoqeruar me akt miratim që të përfshijnë kodet e mbetjeve të rrezikshme si me poshte:**
18 01 01 - Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03);
18 01 03 - Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe në mbështetje të pikës 5 Menaxhimi i Mbetjeve të Shtojcës 1 Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi të Ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", i ndryshuar, Ligjit Nr. 10431 date 09.06.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit", VKM Nr. 798, date 29.09.2010 "Për miratimin e rregullores, Për administrimin e mbetjeve spitalore", VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, "Për miratimin e katalogut të mbetjeve", Udhëzuesi Kombëtar "Për Menaxhimin e Mbetjeve të Rrezikshme Spitalore" dhe sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzuesin Kombëtar "Administrimi i sigurt i Mbetjeve Spitalore", Ligjit Nr. 10081, date 23.02.2009 "Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar dhe VKM Nr. 538 date 26.05.2009 "Për licensat dhe lejet, që trajtohen nga/apo nëpërmjet QKB dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta" e ndryshuar.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Akt Miratimin Higjeno –Sanitar respektiv për objektet ku ushtron aktivitetin e trajtimit të mbetjeve spitalore, të leshuar nga ISHS (Inspektoriati Shendetesor Shtetëror).

Argumentimi: Ky kriter bazohet në kërkesat e nenit 10 të Ligjit Nr. 7643 datë 12.12.1992 "Për Inspektimin Sanitar" i ndryshuar, dhe në nenin 10.3 të Kreut IV "Leja Mjedisore dhe Akt Miratimi Higjeno – Sanitar" të VKM Nr. 798, datë 29.09.2010 "Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore", ku parashikohet: "10.3. Inspektorati Sanitar Shtetëror, pas ekspertimit higjieno-shëndetësor, lëshon akt-miratim higjieno-sanitar për ushtrimin e veprimtarisë".

2.3.4 Raport Monitorimi për shkarkimet e impianteve të cilat përdor për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve sipas VKM 798, date 29.09.2010, "Për administrimin e mbetjeve spitalore" i kryer nga një laborator i akredituar ku operatori të tregojë se zbaton normat për mbrojtjen e mjedisit. Në raport të jetë përfshirë fletë analizë e produktit përfundimtar të impianteve për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve dhe të jetë e identifikueshme që produkti përfundimtar përmbush kërkesat e Landfillit ku do të depozitohen mbetjet pas trajtimit.

Argumentimi: Referuar Ligjit 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar dhe Ligjit 10431, date 09.06.2011 "Për mbrojtjen e Mjedisit"

2.3.5 Një vetëdeklarim se: Pas kryerjes së shërbimit do të dorëzojë vërtetim me shkrim që ka trajtuar/asgjesuar mbetjet sipas kërkesave të Kontratës dhe si dokument do të sjellë të gjithë shiritat e punës (kopje) të impiantit të trajtimit dhe asgjesimit të mbetjeve, sipas VKM 798, Datë 29.09.2010, “Për administrimin e mbetjeve spitalore” për sasinë e mbetjeve të tërhequra nga SRD të cilat janë trajtuar/asgjesuar në impiantin e tij, dhe flete analizat periodike nga laborator i akredituar për cilësinë e produktit përfundimtar të impiantit të trajtimit dhe asgjesimit.

Argumentimi: referuar Ligjit 10448, Datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar dhe Ligjit 10431 ,datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit”i ndryshuar dhe të Ligjit 10463,datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar

2.3.6 Një vetëdeklarim se do të instalojë 2 (dy) banak frigoriferik sipas specifikimeve teknike dhe do ta mirëmbajë atë deri në përfundim të kontratës përfshirë disinfektimin e tij. Ashtu si kërkon kuadri rregullator ligjor për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi:Referuar neni 77 të Ligjit 162 të ndryshuar, datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik dhe neni 41 pika 4/ç të VKM 285,Datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

2.3.7 Operatori duhet të ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira, apo nepermjet cdo menyre posedimi të njohur nga ligji, minimalisht 2 automjete sipas kërkesave të Specifikimeve Teknike dhe Termave të Referencës të ketyre DST. Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:

- Për automjetet në pronësi:
 - Certifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
 - Leje qarkullimi,
 - Akt - kolaudimi
 - Polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt –Miratimet Higjenosanitare,
 - Foto të mjeteve ku të duket qarte targa dhe sinjalistika perkatese.
- Për automjetet që nuk janë në pronësi:
 - Kontratë qiraje ose huapërdorje brenda afatit të vlefshmerise të shoqeruar me aktin e pronësisë së qiradhenesit/pronarit.
 - Leje qarkullimi e mjetit;
 - Akt kolaudimi;
 - Polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet
 - Fotot e mjeteve dhe Akt – Miratimet Higjenosanitare

(Shënim: Në fotot e sjella duhet të jenë qartësisht të dukshme targa, sinjalistika e detyrueshme dhe veshja e brendshme e automjetit sipas përcaktimeve të VKM 798, Datë 29.09.2010, “Për administrimin e mbetjeve spitalore” Shtojca 4) “Kushtet që duhet të respektojnë transportuesi i mbetjeve spitalore infektuese”)

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me pikës 4, të nenit të 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 4/ç e nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Duke marrë në konsideratë faktin se shërbimi objekt i kësaj procedure prokurimi parashikon ndër elementet e tij edhe transportin nga AK në ambientet e trajtimit të operatorit ekonomik, si dhe te produkti final nga ambientet e operatorit drejt landfillit, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën me qëllim ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë se ka numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit duhet të jetë jo më pak se 4(katër) punonjës.

Per kete duhet te paraqese:

- a. Vertetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetsores në të cilin të jetë i përcaktuar numri i punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.**
- b. List- pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.**

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë të lidhur me landfill të liçensuar për depozitimin e produktit final respektiv që del nga proceset e trajtimit/ asgjësimit, e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave. Ky kriter kërkohet në përputhje me kërkesat e VKM 798, datë 29.09.2010, pasi AK si krijuesi mbetjeve është përgjegjës deri në hallken e fundit të asgjësimit të mbetjeve spitalore që krijon.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, si dhe duke qenë se në bazë të VKM nr. 798, datë 29.09.2010, “Për miratimin e rregullores, ‘Për administrimin e mbetjeve spitalore’”, strukturat spitalore si krijues të mbetjeve janë përgjegjës deri në hallken e fundit të asgjësimit të mbetjeve spitalore që krijojnë, AK kërkon që operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratë të lidhur me subjekt të autorizuar sipas ligjit për depozitimin e produktit final respektiv që del nga proceset e trajtimit/asgjësimit, e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave. Këto dokumente kërkohej me qëllim realizimin me sukses të asgjësimit final të mbetjeve si element mjaft i rëndësishëm i procesit ku dokumentohet që OE është në këtë fushë aktiviteti dhe e kryen realisht këtë lloj shërbimi. Duke patur parasysh abuzimet e ndryshme të cilat i bëhen këtij procesi, ky kriter është mëse i domosdoshëm dhe gjithashtu do të kërkohej në vazhdimësi si pjesë e monitorimit të zbatimit të kontratës.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues përkatës për kryerjen e të gjitha shërbimeve. Për këtë operatori duhet të paraqesë dokumentacionin se ka punësuar dhe regjistruar në listpagesa ose me kontratë shërbimi:

- **1(një)Inxhinier Mjedisi ose 1 (një) Ekspert Mjedisor, të çertifikuar nga Institucioni Përkatës (Ministria e Mjedisit), për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomikduhet të paraqesin:**
 - **Librezë pune përkatëse**
 - **CV përkatëse**
 - **Kontratë pune/ sherbimi e vlefshme përkatëse**
 - **Diplomë (Inxhinieri Mjedisi) ose Çertifikatë (EkspertiMjedisor)**

Argumentimi: Referuar nenit 77 të Ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik” te ndryshuar dhe neni 41 pika 4/a të VKM 285, Datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

2.3.11 Operatori duhet të furnizojë me kontenitorë sipas standarteve dhe kërkesave të VKM Nr. 798 date 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore” pika 8/4 dhe 8/5 të kreut III. Për të provuar plotësimin e këtij kriteri, operatori duhet të paraqesë në ambjentet e SRD-së në datën dhe orën e hapjes së tenderit nga një mostër të paketimeve:

- a. **Përmbetjet e mprehta, me KOD 18 01 01, Kontenitor Plastik me 1 perdorim (3 L ose 5 L me tolerance diference 0.5L)**
- b. **Përmbetjet me potencial infektues, me KOD 18 01 03, Kontenitor Kartoni ose Plastik me 1 perdorim me Qese të Verdhë të loguar me 1 përdorim (rreth 40L ose rreth 60L)**
 - i. **Të jenë të shoqëruara me qese që vendoset në pjesën e brendshme.**
 - ii. **Te jenë ekologjike (që nuk lëshojnë substance gjatë djegjes)**
- iii. **Të jenë të palosshme për të zënë pak hapësirë në ruajtje, të lehta për t'u shpalosur dhe mbyllur, me mbajtëseanësoretështangëtdhetëqëndrueshme.**
- c. **Përmbetjet anatomike, me KOD 18 01 02, Kontenitor Plastik një përdorimesh me ngjyrë të verdhë të loguara me 1 përdorim.**
- d. **Përmbetjet citostatike, me KOD 18 01 08, Kontenitor Plastik një përdorimesh me ngjyrë të kuqe ose kafe ose të zezë dhe qese me ngjyrë të kuqe ose kafe ose të zezë të loguara me 1përdorim.**

(Shënim: Mostrat e dorëzuara duhet të jenë të shoqëruara me listen e inventarizimit. Nëse ka mungesa mostrash për artikuj të vecantë ose nëse mostra/t nuk është/janë në përputhje me specifikimet teknike, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht OE do të skualifikohet.)

Argumentimi: Referuar nenit 77 të Ligjit 162, Datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar dhe neni 41 pika 4/a të VKM 285, Datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

2.3.12 Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qira/perdorim, apo nepermjet cdo menyre posedimi te njohur nga ligji, impiant/e, e meposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt i ketyre DST, sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe te VKM-se per miratimin e rregullores “Per menaxhimin e mbetjeve spitalore”, (Rregullorja), si më poshtë:

- a. **Impiant primar për trajtimin me sterilizim, me një prej metodave të përcaktuara ne VKM nr 798, date 29.09.2010 dhe impiant me të njëjtën metodë back up**

b. Impiant primar për asgjësimin me incenerim të mbetjeve të rrezikshme spitalore të përcaktuara në VKM nr 798, datë 29.09.2010 dhe impiant incenerimi back up

Per të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentet e mëposhtme provuese:

- Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qira të pajisjes (ku afati i marrjes me qira/përdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi)

Impiantet për trajtimin/asgjësimin duhet të jenë të pajisur me:

a) a.1. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) për impiantet për asgjësimin me incenerim

a.2. Leje Mjedisore të tipit A (III.1.C) ose të tipit B (III.1.B) për impiantet për trajtimin përveç incenerimit ose të jenë pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;

b) Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit impiant

c) Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ku përcaktohet se : “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se : “4.Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Në bazë të Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, VKM nr. 798, datë 29.09.2010, “Për miratimin e rregullores, ‘Për administrimin e mbetjeve spitalore’”, VKM Nr. 402, datë 30.06.2021, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, Udhëzuesit Kombëtar të Administrimit të sigurtë të mbetjeve spitalore në varesi të rrymes së mbetjeve janë kërkuar impiantet baze për realizimin me sukses të këtij shërbimi.

Sic edhe përcaktohet në Tabelën 1 të Udhëzuesit Kombëtar të Administrimit të sigurtë të mbetjeve spitalore, mbetjet që i përkasin rrymave të mbetjeve infektive (18 01 01 dhe 18 01 03) trajtohen me metodat e nxehtësisë, ndërsa mbetjet që i përkasin rrymave të mbetjeve Mbetje citotoksike (18 01 08), Medikamente & Kimikate të tjera farmaceutike (18 01 09), Pjesë trupi të dallueshme, Placenta etj (18 01 02), trajtohen me metodën e incenerimit. Me tej, në Kreun 11 të Udhëzuesit Kombëtar të Administrimit të sigurtë të mbetjeve spitalore përcaktohen edhe kushtet e vecanta që duhet të plotësohen për cdo metodë trajtimi/asgjësimi.

Impjantet back up (zevendesues) jane kerkuar duke mbajtur ne konsiderate, se impjantet kryesore do jene ne gjendje pune te vazhdueshme, kanë nevojë edhe për periudha mirëmbajtjeje parandaluese ose/dhe korrigjuese, si dhe duke parashikuar që mund të pësojnë difekte të zgjatura në kohë ose edhe të pariparueshme, është vlerësuar e nevojshme që të kërkohej edhe një makineri back up (zevendesuese), për secilin impiant me të njëjtin kapacitet, në mënyrë që të mos rrezikohet ndërprerja e shërbimit. Kjo edhe sepse, edhe në rast se OE do të zëvendësonte impiantin e difektuar me një të ri, do të merrte sidoqoftë një kohë të gjatë pajisja e tyre me lejet e licencat përkatëse, çka sërish do të shkaktonte ndërprerje me muaj të ketij shërbimi teper sensitiv.

Ky qendrim eshte mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimit Publik në :

- vendimin nr. 443/2023 date 30.05.2023, ku në pikën III.1.30, ku ndër të tjera është shprehur se III.1.30. *“Ndërsa lidhur me pretendimin për sa i përket impianteve back up, Komisioni gjykon, se duke marrë shkasë nga natyra, lloji i veçantë i kësaj procedure prokurimi, si dhe ndikimi dhe ndjeshmëria e lartë që ka kjo procedurë, disponueshmëria nga operatorët ekonomikë përveç impianteve kryesore edhe e atyre back up (ose zëvendësues) gjykon, se është një kërkesë e arsyeshme dhe e domosdoshme kjo për vetë faktin se i shërben autoriteti kontraktor si garanci që në rast të ndonjë avarie ose mosfunksionimi të impianteve kryesore operatorët ekonomikë do të vendosin në funksion impjantet back up ose zëvendësues, me qëllim që të sigurohet që ky shërbim do të ofrohet në mënyrë të pandërprerë nga operatorët ekonomikë, e që rrjedhimisht do të sillte edhe realizimin me sukses të këtij shërbimi sensitiv. Pasi një sistem impiantesh reserve back up do të garantonte vazhdueshmërinë e shërbimit në rast defektesh, mirëmbajtjesh, apo raste të një mbingarkese të sasive tej parashikimeve të autoritetit kontraktor....”*dhe

- Vendimi nr.564/2023 date 05.07.2023 ku ne piken III.3.7 ndër të tjera është shprehur se *“.....Ndërsa lidhur me pretendimin për impjantet dhe makineritë back up, Komisioni gjykon, se duke marrë shkas nga natyra, lloji i veçantë i kësaj procedure prokurimi, si dhe ndikimi dhe ndjeshmëria e lartë që ka kjo procedurë, disponueshmëria nga operatorët ekonomikë përveç impianteve dhe makinerisë kryesore edhe të atyre back up (ose zëvendësues) gjykon, se është një kërkesë e arsyeshme dhe e domosdoshme, kjo për vetë faktin se i shërben autoritetit kontraktor si garanci, që në rast të ndonjë avarie ose mosfunksionimi të impianteve ose makinerisë kryesore operatorët ekonomikë do të vendosin në funksion impjantet apo makinerinë back up ose zëvendësues, me qëllim që të sigurohet që ky shërbim do të ofrohet në mënyrë të pandërprerë nga operatorët ekonomikë. Kjo rrjedhimisht do të sillte edhe realizimin me sukses të këtij shërbimi sensitiv, pasi një sistem impiantesh dhe makinerish rezerve back up do të garantonte vazhdueshmërinë e shërbimit në rast defektesh, mirëmbajtjesh, apo raste të një mbingarkese të sasive tej parashikimeve të autoritetit kontraktor.....”*

Disponimi i impjanteve vertetohet nepermjet dokumentit për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera apo nepermjet cdo menyre posedimi te njohur nga ligji të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/perdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi), eshte lene me alternative pra mund te jete ne pronesi ose me qira (ku afati i marrjes me qera/perdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi) ne menyre qe te rrise pjesmarrjen dhe qe mos te penalizojë asnjë OE.

Gjithashtu kerkohet katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit implant ne menyre qe te vertetohet disponueshmeria dhe besueshmeria e ketij impjanti. Afati i marrjes me qera te eshte lene minimalisht me afatin e ekzekutimit te ketij objekti prokurimi ne menyre qe te mos cenoje ekzekutimin sherbimit

Kërkohet gjithashtu qe implantet të jenë të pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 (argumentuar tek pikat perkatese 2.1.1 dhe 2.1.2)

Deklarata e Konformitetit CE per secilin implant eshte kerkuar pasi ne kete periudhe mjaft te ndjeshme per shendetin publik per shkak te rrezeve epidemiologjike, eshte e rendesishme qe te mos tolerohet asnje cedim ne kapacitete te sa më të sigurta teknike qe kerkohet te kene ofruesit e ketij sherbimi. Vendorsja e kësaj kërkesë është në përputhje me ligjin nr.10

489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i cili rregullon në mënyrë të posacme nevojën e pasjes së Deklaratës së Konformitetit CE, si kusht për vendosjen në treg dhe instalimin e produkteve industrial, vecanërisht impiante që disiplinoohen me rregulla teknikë të posacme sic janë implantet që punojnë me lëndë djegëse, me avull, me presion, apo me sisteme elektrike.

2.3.13 Transporti i mbetjeve do te behet nga operatori me automjet duke respektuar standartin sipas VKM 798, Date 29.09.2010, “Për administrimin e mbetjeve spitalore”

Shtojca 4) “Kushtet qe duhet te respektoje transportuesi i mbetjeve spitalore infektuese”

2.3.14 Operatori duhet të siguroje ambalazhin përkates sipas specifikimeve të caktuara në Udhëzuesin Kombëtar per Administrimin e Sigurt te Mbetjeve Spitalore. Furnizimi me ambalazh 1(një) perdorimesh (kontenitore kartoni me qese të verdhë dhe kontenitorë plastik me kapak) do të bëhet cdo javë ose edhe me shpesh sipas kërkesës së AK.

2.3.15 Operatori duhet të instalojë dy frigorifer (banak frigoriferik) në ambjentet e SRD-se me nje kapacitet me te madh se 200 litra dhe temperature -18°C për ruajtjen e mbetjeve të lëngshme dhe të ngurta deri në momentin e transportit me mjetet e tij për në impiantin e trajtimit. Pas marrjes së mbetjeve, operatori do të disinjektoje frigoriferin dhe ambjentin përreth, si dhe do të bëjë mirëmbajtjen e frigoriferit.

2.3.16 Operatori ekonomik duhet të sjell në përdorim 2 (dy) peshore elektrike mbi 100 kg, një që shërben për të peshuar mbetjet e krijuara në pavion dhe një për të peshuar mbetjet qe do ti dorezohen operatorit ekonomik. Peshoret duhet te jene te kolauduar.

- Mbetjet e mbledhura në kontenitorët perkates do të peshohen në prani të dy palëve duke u zbritur pesha e ambalazhit.

- Operatori dhe Perfaqesuesit e SRD për cdo dorëzim mbetjesh tek operatori për asgjësim, do të plotësojnë “Dokumentin e Dorëzimit të Mbetjeve të Rrezikshme”, sipas VKM 371, Date 11.06.2014, “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre” i ndryshuar.

- OE bashkë me dokumentin e dorëzimit do të kthejë në Spital konfirmimin me shkrim se ka trajtuar/asgjësuar mbetjet spitalore sipas kërkesave të kontratës dhe do të bashkangjisë të gjithë shiritat e punës (kopje) të impiantit të cilin përdor për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve sipas VKM 798, Date 29.09.2010, “Për administrimin e mbetjeve spitalore”. OE do të dorëzojë cdo 3-muaj flete – analizë nga laborator i akredituar të produktit përfundimtar

impiantit te perdorur per trajtimin me sterilizim dhe asgjesimin ku të tregohet cilesia e shërbimit sipas kërkesave të VKM 798, datë 29.09.2010.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Shtojca 6.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Rrymat e mbetjeve

Në zbatim të VKM 402, Datë 30.06.2021 “Për Miratimin e Katalogut të mbetjeve”, sqarojmë se Spitali Rajonal Durrës gjeneron mbetje sipas kodeve të mëposhtme:

- **18 MBETJE NGA KUJDESI SHËNDETËSOR OSE VETERINAR DHE/OSE NGA VEPRIMTARITË KËRKIMORE QË LIDHEN ME TO (me përjashtim të mbetjeve të kuzhinave dhe restoranteve që nuk lidhen drejtpërdrejt me kujdesin shëndetësor)**
- **18 01 Mbetjet nga reparti i lindjes dhe mbetjet që lidhen me diagnostikimin, trajtimin ose parandalimin e sëmundjeve të njerëzit**
- **18 01 01 Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta (përveç 18 01 03)**

- **18 01 02** *Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset e gjakut dhe rezervat e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03)*
- **18 01 03*** *Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave u nënshtrohen kërkesave të veçanta për të parandaluar infeksionet*
- **18 01 08*** *Medikamente citostatike dhe citotoksike*
- **18 01 09** *Medikamente të tjera përveç atyre të përmendura në 18 01 08*

Argumentimi: Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36 të LPPsi dhe nenit 41, pika 1, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar: “Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.”

Ky Procesverbal u ngarkua ne SPE nga Njesia e Prokurimit sipas modelit te APP-se, sipas materialit me **nr. 554/24 date 26.05.2025** me titull ”Dergimi i specifikimeve teknike, Kerkesave te vecanta Teknike per Kualifikim dhe Perllogaritjen e Vleres Limit te Kontrates” te dorezuar nga Njesia e Posacme e ngritur me urdherin e brendshem **nr. 554/1 prot., date 30.04.2025** i perbere nga specialiste te fushes.

Njesia e Prokurimit :